




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-757/15
Dep. 02	Br. Prot. 01-757/15
Nr. f. pag. 02	Data 26.03.2015
Nr. pages	Datum 26.03.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.03.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-330-15 për z.Nevzat Rushiti-Këshilltar në Asamblenë Komunale Gjilan, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-330-15, për Zyrtarin e lartë, z.Nevzat Rushiti-Këshilltar në Asamblenë Komunale Gjilan, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Rushiti fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D.DPK-03-02/722/15), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Rushiti, është deklaruar se do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK/DPKI-03-02-722/15) në të cilën shihet se z.Rushiti tash nuk e ushtron funksionin e personit të autorizuar të biznesi N.t.sh. "Bera-Tech", sepse në këtë pozitë e ka zgjedhur një person të besuar, ashtu siç e kërkon ligji për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

